



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës
DIVIZIONI JURIDIK

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____. _____. 2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: “ASI-2A CO“ shpk” NIPT: NIPT K53002402C; Adresa: Rr.Skënderbeu, pall.18 H.6, Fier.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Punë Publike

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 34617-06-28-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i dy kabinave elektrike nr. 1 TMGJ, nr. 7 TK dhe zyra e lejeve tek HSH porta 3, të dëmtuara nga tërmeti” 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data fillimit të tyre.**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 90 datë 4 Korrik 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojme se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” sh.p.k. me NIPT K53002402C me ofertë ekonomike në vlerën 6.792.745 (gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë, pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k. me NIPT M03116403L me ofertë ekonomike në vlerën 6.089.498 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k. me NIPT M03116403L me ofertë ekonomike në vlerën 6.089.498 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH.

Në dokumentacionin e dorëzuar KVO vërejtë këto mungesa:

1. Mos deklarimin në Shtojcën 8 të vedklarimit të Ekspertit Zjarrfikës, në pjesën III „Kriteret Përzgjedhjes/Kualifikimit“ pika B Deklaratë „Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate“ dhe Nenit 26 „Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit“ i Ligjit Prokurimit Publik i ndryshuar.

2. AK nëpërmjet DST publikuar/zbatuar pikës 2.3.6 të Kritereve teknike 2.3 ka kërkuar:

„Operatori ekonomik pjesmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetdeklarimit.

Secili nga punëtorja duhet të jetë në listëpagesën e shoqërisë të paktën tre muajt e fundit. Secili nga punëtorja duhet të figurojë në listëpagesë me përshkrimin përkatës të profesionit që lidhet dhe i përket fushës së ndërtimit apo që lidhet ngushtë me të. Verifikimi i përshkrimit të profesionit nuk është i nevojshëm kur profesioni apo funksioni i kërkuar specifikohet në kontratën e punës“.

OE nuk ka paraqitur kontrata individuale të punës ku të cilësohet profesioni përkatës i kërkuar por ka paraqitur në zbatim të nenit të mësipërm listëpagesat e shoqërisë.

AK në zbatim të VKM nr.514 datë 20.09.2017 „Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar“ bëri verifikimin e profesioneve sipas seksionit 11) Detyra, Funksioni, Profesionit apo puna që ka kryer punonjësi i deklaruar.

Nga ky verifikim rezultoi se, punonjësit e deklaruar:

Alfred Rrapaj është deklaruar shofer dhe rezulton sipas listëpagesave Agronom.

Kastriot Ferro është deklaruar Teknik Ndërtimi dhe rezulton sipas listëpagesës Punëtor Llaci.

Aldis Begaj është deklaruar hidraulik dhe rezulton sipas listëpagesës Saldator.

Kamber Malka është deklaruar hidraulik dhe rezulton sipas listëpagesës Saldator.

Niko Bucka është deklaruar shofer dhe rezulton sipas listëpagës Auditues.

Myzafer Doko është deklaruar murator/suvatues dhe në listëpagesë rezulton Saldator.

Shpëtim Alibeaj është deklaruar manovrator dhe rezulton sipas listëpagesës Punëtor Pastrimi.

Ymer Kamberaj është deklaruar saldator dhe rezulton sipas listëpagesës punëtor llaci.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se oferta e operatorit ekonomik, • OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të s’kualifikoje këtë ofertë

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ASI-2A CO“ shpk” NIPT: NIPT K53002402C; Adresa: Rr.Skënderbeu, pall.18 H.6, Fier, me ofertë ekonomike në vlerën 6.792.745 (gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë, pa TVSH është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

